



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 930/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Lindita Demelezi kandidate për kuvendin komunal në Viti nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Lindita Demelezi kandidate për kuvendin komunal në Viti nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Viti, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpallje së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 11:20, ka pranuar një apel nga Lindita Demelezi kandidate për kuvendin komunal në Viti nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Viti në të cilin pretendon se i mungojnë votat dhe kërkon që të rinumërohen të gjitha vota për vendvotimet 2617D/04d/01R; 2633d/02d/01R; 2609D/01R/02R; 2601x/02R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë të apelit dhe vlerësimit të provave, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesja e apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe nuk e ka dëshmuar me asnjë provë krahasueshmërinë e votave për të cilat pretendon se i mungojnë.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara për shkak të mungesës së dëshmive lidhur me pretendimet e parashtruara në apel dhe se e njëjta nuk i plotëson standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL Anr.930/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*